



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

Analiza epidemiologjike mujore (Pasqyra 14 Sh)


ANALIZA EPIDEMIOLOGJIKE MUJORE

JANAR, 2018

Analiza epidemiologjike e sëmundshmërisë infektive bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh. Pasqyra 14-Sh plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare në DEKSI, ISHP brenda datës 10 të çdo muaji. Në muajin shkurt, 2018 kanë raportuar 35 rrethe, nuk ka raportuar vetëm rrethi Kavajë.

❖ Sëmundjet diarreike

Gjatë muajit janar 2018 vëmë re se kemi një rritje të incidencës të sëmundjeve diarreike për 100.000 banorë (194.8) krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, janar 2017 (incidenca 170.8). Numri i rasteve sipas çdo nozologjie të raportuara nga DRSH/DSHP-të për muajin janar 2018 duke e krahasuar me muajin janar 2017 paraqiten në grafikun e mëposhtëm:




Grafiku 1. Numri i rasteve me sëmundje diarreike, janar 2017 dhe 2018 te raportuara nga DRSH/DSHP-të.

Rrethi me numrin më të madh të rasteve me Salmonelozë jotifioide për muajin janar 2018 është Shkodra me 29 raste të konfirmuara. Rrethet Berat dhe Lezhë kanë vetëm nga një rast të konfirmuar.

Rastet e raportuara me Shigelozë janë: Shkodër me 25 raste të konfirmuara, Kukës 5 raste, Durrësi 2 raste dhe Lezha një rast, nga të cilët vetëm 27 raste janë të konfirmuara dhe gjashtë raste janë të suspektuara për shkak të pamundësisë të laboratorit rastet nuk konfirmohen në laboratorët e rretheve.

Numri i toksikoinfeksioneve alimentare në janar 2018 ka një rritje në krahasim me muajin janar 2017 dhe rrethet me problematike janë: Bulqizë (122 raste), Kukës (32 raste), Berat (24 raste), Durrës (4 raste) dhe një rast në Korçë.

Gastroenteritet e paspecifikuar janë të shpërndara në të gjitha qarqet e vendit. Duhet theksuar që numri i larte i rasteve të raportuara me toksikoinfeksione alimentare dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rretheve të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.




Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve sipas DRSH/DSHP-ve, dhjetor 2016 dhe 2017.

❖ Zoonozat


	Janar 2018 (Raste)	Incidenca janar 2018 (raste/100,000 banore)	Janar 2017 (raste)	Incidenca janar 2017 (raste/100,000 banore)
Antraks (Plasje)	0	0	2	0.1
Brucelozë	8	0.2	6	0.2
Leptospirozë	0	0	1	0.0
TBc ekstrapulmonar	4	0.1	3	0.1
Rikecie	0	0	1	0.04

Tabela 1. Shpërndarja e zoonozave numri total i rasteve (Bruceloze, Antraks, Leptospirozë, Tbc ekstrapulmonar, Rikecie), në muajin Janar 2017 dhe 2018 te raportuara nga DRSH/DSHP-te.



Grafiku 3. Shpërndarja e zoonozave (Antraks, Bruceloze, Tbc ekstrapulmonar, Leptospiroze, Rikecioze) në numër total rastesh në muajin Janar 2017 dhe 2018 të raportuara nga DRSH/DSHP-te.

BRUCELOZA



Grafiku 4. Shpërndarja gjeografike e Brucelozës sipas rretheve në muajin Janar 2017 dhe 2018 të raportuara nga DRSH/DSHP-te.

Në total në muajin Janar 2018 janë raportuar 8 raste me Brucelozë kundrejt 6 raste të raportuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rastet për muajin Janar 2018 janë raportuar nga rrethet Pogradec (2 raste), Dibër (2) Librazhd (3).


ANTRAKSI

Antraksi rezulton me 0 raste raportimi për muajin Janar 2018 kundrejt 2 raste të raportuar në të njëjtën periudhë të muajit Janar të vitit 2017.

LEPTOSPIROZA

Në total për muajin Janar 2018 është raportuar 0 raste me Leptospirozë kundrejt 1 rasti të raportuar në muajin Janar 2017.

TBC EKSTRAPULMNONAR



Grafiku 5: Shpërndarja gjeografike sipas rretheve e Tbc ekstrapulmonar janar 2017 dhe 2018 të raportuara nga DRSH/DSHP-të


Nga të dhënat e raportuara në muajin Janar 2018 rezultojnë 4 raste me TBC ekstrapulmonar rastet janë raportuar nga rrethi Tiranë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017 vërehet një ulje e lehtë e numrit të rasteve të raportuara siç vihet re në tabelën 1.

Rikecie kemi 0 raste të raportuar për muajin Janar 2018 kundrejt 1 rasti të raportuar në Janar 2018. Rasti i raportuar në janar 2018 i përket rrethit Elbasan.


❖ Sëmundjet e PKI

Fruthi:


Në datën 10.01.2018 pasdite dhe datën 11.01.2018 sillen në ISHP dy mostra për dy raste të dyshuara për Fruth të cilat testohen në datën 11.01.2018 dhe rezultojnë pozitive për Fruth. Nga hetimi i mëtejshëm epidemiologjik rezultuan raste të tjera dhe në total për muajin janar 2018 janë 106 raste nga të cilët 57 qe janë laboratorikisht të konfirmuara për Fruth (IgM pozitiv për Fruth) dhe 49 janë raste qe rezultojnë negative. Rastet i përkasin kryesisht moshës femërore. Shpërndarja e rasteve pozitiv me fruth sipas ditëve paraqitet në grafikun e mëposhtëm.




Grafiku 6. Kurba epidemike e shperthimit, rastet e konfirmuara me fruth, Janar 2018.



Grafiku 7: Rezultatet laboratorik sipas gjinise gjate muajit janar 2018.



Grafiku 8. Shperndarja e rasteve tye dyshuara dhe konfirmuara per fruth sipas grup-moshave, janar 2018.



Grafiku 9. Shperndarja e rasteve tye dyshuara dhe konfirmuara per fruth sipas rretheve, janar 2018.

Varicele:

Rastet me varicele hasen kryesisht ne grupmoshën pediatrike 0-14 vjeç dhe ne kolektiva te mbyllura si institucionet parashkollore çerdhe kopshte dhe shkolla ne forme shpërthimesh te kufizuara.

❖ Ethe hemorragjike


Nga survejanca e bazuara në rast, gjatë periudhës Janar 2018 krahasuar me të njëjtën periudhe Janar 2017, është venë re një trend shumë i ulët i rasteve të dyshuara me ethe hemorragjike, asnjë rast të dyshuar në muajin Janar 2018 dhe 4 raste të dyshuara në Janar të vitit 2017. Nga rastet e dyshuara gjatë kësaj periudhe kemi vetëm një rast të konfirmuar me Ethe Hemorragjike me Sindrome Renal, nga rrethi i Laçit, mashkull, i moshës 26 vjeç dhe 3 raste negative, përkatësisht 1 rast nga rrethi i Tiranës, mashkull, i moshës 57 vjeç dhe dy raste meshkuj te rrethit te Elbasanit të moshës 57 vjeç dhe 27 vjeç.

Periudha	Raste te dyshuara	Raste te konfirmuara
Janar 2017	3	1
Janar 2018	0	0

Tabela 2. Totali i rasteve te dyshuara me diagnozen Ethe hemorragjike gjate periudhes Janar 2017 dhe 2018 te raportuara nga DRS/DSHP-te

❖ Meningoencefalite

Për sa i përket rasteve te dyshuara me diagnozën Meningoencefalite, duke u mbështetur në të dhënat e Pasqyrës 14Sh, është venë re një trend në rënie i rasteve të dyshuara me encefalit te paspecifikuar, gjatë periudhës Janar 2018 krahasuar me të njëjtën periudhe të vitit 2017. Ndërkohë në lidhje me rastet meningit bakterial jo meningokoksik, meningokoksik dhe rasteve me encefalit te paspecifikuar, kemi një trend të qëndrueshëm krahasuar me të njëjtën periudhe të një viti më parë, 2017. Theksojmë që gjate muajit Janar te viteve 2017 dhe 2018, nuk kemi asnjë rast të raportuar të dyshuar me meningit viral dhe tuberkular.



Grafiku 10. Totali i rasteve te dyshuara meningoencefalite gjatë periudhës Janar 2017 dhe 2018 te raportuara nga DRS/DSHP-te

Gr.Mosha	<1vjeç	1-4 vjeç	5-14 vjeç	15-24 vjeç	25-44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç
Raste	1	0	0	2	2	1	2

Tabela 3. Totali i rasteve te dyshuara meningoencefalite, sipas grupmoshës gjatë periudhës Janar 2017 dhe 2018 te raportuara nga DRS/DSHP-të.

Në lidhje me totalin e meningoencefaliteve gjatë periudhës Janar 2017 dhe Janar 2018, kemi predominim të gjinisë meshkuj në raport 6:2, me hasje në nivel më të lartë në grupmoshën e rritur (tabela.3). Theksojmë që rastet janë

raportuar dhe hetuar njëkohësisht nga DSHP, Sektori Epidemiologjisë, në rrethet Tirane (4 raste), Vlore (1 rast), Laç (1 rast), Bulqizë (1 rast) dhe Elbasan (1 rast).

❖ Leishmanie viscerale

Në muajin Janar 2018 kemi patur një rast të moshës më të vogël se një vjeç me Leishmanie viscerale nga rrethi i Krujës. Në muajin Janar të vitit 2017 kemi patur një rast të grupmoshës 1-4 vjeç nga rrethi i Vlorës.


❖ Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit Janar 2018 janë raportuar në total 20 raste me hepatite virale akute nga të cilat 5 (25%) raste janë Hepatite virale të paspecifikuar, 11 (55%) raste me Hepatit viral akut B dhe 4 (20%) rast me Hepatit virale as A as B. (tabela 4).

Periudha kohore	Hepatiti i paspecifikuar	Hepatit viral A	Hepatit viral B	Hepatit viral as A as B
Janar 2017	16	1	8	1
Janar 2018	5	0	11	4

Tabela 4

Siç shihet edhe nga grafiku 1, në krahasim me të njëjtin muaj një vit më parë, numri rasteve të raportuar me hepatite virale akute ka pësuar rritje për hepatitin viral B dhe hepatitin viral A as B. Ndërkohë këtë muaj nuk ka patur asnjë rast me hepatit viral A. Rënie e numrit vërehet për hepatitin viral të paspecifikuar.



Grafiku 11: Numri i rasteve me hepatite virale akute, janar 2017 dhe 2018 të raportuara nga DRSH/DSHP-të.

Duhet theksuar se rastet me Hepatit viral të paspecifikuar gjatë muajit janar të vitit 2018 i përkasin grupmoshës <1 vjeç- 1 (20%) rast, grupmoshës 5-14vjeç -1 (20%) rast, grupmoshës 25-44 vjeç -3 (60%) raste. Gjate këtij muaji nuk është raportuar asnjë rast me hepatit viral A.

Përsa i përket HBV, 3 (27.3%) raste i përkasin moshës 25-44 vjeç, 5 (45.4%) raste grupmoshës 45-59 vjeç dhe 3 (27.3%) raste grupmoshës mbi 60 vjeç. Ndërsa rastet me hepatit as A as B janë përkatësisht: 25-44 vjeç -1 (25%) rast, 45-59 vjeç -2 (50%) raste, mbi 60 vjeç -1 (25%) raste. Siç shihet rastet e raportuara janë të grupmoshës së rritur mbi 25 vjeç.

Ne lidhje me shpërndarjen sipas rretheve, gjatë këtij muaji Korça ka raportuar rastet me Hepatite virale B (4) e ndjekur nga Tirana (3). Rrethet Durrës, Elbasan, Shkodër, Tirane kane raportuar nga 1 rast me hepatit viral as A as B.

Nga hetimi epidemiologjik i kryer për këto rastet rezultoi se janë raste sporadike pa lidhje epidemiologjike mes tyre.


Vazhdimi i raportimit të rasteve me hepatit viral të paspecifikuar ndodh për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme laboratorike për diagnostikimin e tyre në laboratorët mikrobiologjike të DSHP në rrethet e vendit.

❖ Tuberkulozi pulmonar

Gjatë periudhës Janar 2018, krahasuar me muajin Janar 2017, vihet re një ulje e shume e lehtë e numrit të rasteve të raportuara me tuberkuloz pulmonar përkatësisht nga 13 raste në Janar 2017 në 12 raste në muajin Janar 2018. Duhet theksuar se burimi i të dhënave për të muajt është SMBS.

Sipas SMBS në muajin Janar 2017 janë raportuar 13 raste (10 meshkuj dhe 3 femra), ndërsa në muajin Janar 2018 janë raportuar 12 raste (8 meshkuj dhe 4 femra). Vihet re një ulje e numrit të rasteve me TBC pulmonar në krahasim me muajin dhjetor paraardhës.

Përsa i përket shpërndarjes sipas rretheve në të dyja periudhat, Tirana paraqet numrin më të lartë të rasteve, 5 raste në Janar 2017 dhe të njëjtin numër prej 5 rastesh në Janar 2018, ndërsa nga rrethet Shkodër ka raportuar 3 raste me TBC pulmonar në muajin Janar 2018. Rrethet e tjera (që kanë raportuar), kanë raportuar nga një rast me TBC pulmonar në muajt respektive.



Grafiku 12: Paraqitja e numrit të rasteve me diagnozën Tuberkuloz pulmonar, gjatë periudhës Janar 2017 dhe 2018 të raportuara nga DRSH/DSHP-te

❖ HIV/AIDS

Survejaca e SMBS ne lidhje me diagnozën AIDS nuk paraqet ndonjë rast te raportuar ne muajin Janar 2017 dhe ne Janar 2018. Sipas te dhënave te Programit Kombëtar te HIV/AIDS, gjate muajit Janar 2017 janë raportuar 6 raste HIV pozitive, ndërsa ne muajin Janar 2018 nuk është raportuar ndonjë rast HIV pozitiv. Shpërndarja sipas gjinisë e rasteve te muajit Janar 2017, paraqet 3 raste tek meshkujt dhe 3 raste i përkasin gjinisë femërore. Shpërndarja sipas grupmoshës tregon se grupmosha mbi 25-45 vjeç zë 83% te rasteve ne muajin Janar 2017.

Hartoi: **Departamenti i Kontrollit te Sëmundjeve Infektive, Sektori i Epidemiologjisë, Programi Kombëtar i Tuberkulozit**

Silvia Bino, Eugena Tomini, Artan Simaku, Adela Vasili, Luljeta Alla, Elona Kureta, Rovena Daja, Marjeta Dervishi, Donika Bardhi.

Editoi: Rovena Daja

INSTITUTI I
SHENDETIT
PUBLIK

DEKSI